

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.10.2023*

**4.10.2023  
Ora 12:31**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për dhënien e mandatit Kryetarit të Bashkisë Kukës, Qarku Kukës, zotit Albert Bislim Halilaj, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në zgjedhjet e pjesshme të datës 24 Shtator 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj.**

**Parti Politike: S’ka prezent!**

**Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita! Në seancën e sotme kemi në rend dite:

- Projektvendimin që lidhet me dhënien e mandatit të kandidatit fitues të zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023;
- Shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të thelluar nga ana e prokurorisë për disa subjekte;
- Plotësimin e vakancave për disa këshilla bashkiakë.

Mirë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me dhënien e mandatit të kandidatit fitues të zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023. Po, zoti Sekretar!

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit! Në mbështetje të Dekretit nr. 186, datë 11.8.2023, të Presidentit të Republikës, në datën 24 shtator 2023, u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.10.2023*

për kryetar të Bashkisë Kukës. Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse. Bazuar në nenin 33, shkronja “g”, e Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11, me vendimin ka shpallur fitues zotin Albert Bislim Halilaj, si Kryetar të Bashkisë Kukës, të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste. Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “i” dhe nenin 166, të Kodit Zgjedhor, i propozojmë Komisionerit dhënien e mandatit të kryetarit të Bashkisë Kukës, zotit Albert Bislim Halilaj, të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë vendosim:

- Dhënien e mandatit të kryetarit të Bashkisë Kukës, Qarku Kukës, zotit Albert Bislim Halilaj, të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tre ditëve nga shpallja e tij.

**Vendimi nr. 786**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.10.2023*

**4.10.2023  
Ora 12:33**

**RENDI I DITËS**

*“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues zotin Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për kryetar në Bashkinë Mallakastër, Qarku Fier”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj.**

**Parti Politike: S’ka prezent!**

**Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikat e tjera!

**Z. Y. Merkaj:** Në zbatim të ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin e formularit të vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati për kryetar bashkie”. Në zbatim të këtyre dispozitave, zoti Qerim Ismailaj, kandidat për kryetar në Bashkinë Mallakastër, në datë 31.3.2023, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me numër unik “FR-PS-16657”. KQZ bëri verifikimin paraprak dhe ka konstatuar se kandidati për kryetar bashkie, nuk është në kushtet e ndalimit. Nga verifikimi i formularit u konstatua se në

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.10.2023*

rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, kandidati i është përgjigjur që ka qenë i dënuar një herë me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe pyetjes 3 “a keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoriteti i huaj, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “PO”. Nga konstatimet e mësipërme, bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra në formularin e vetëdeklarimit. Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin zoti Qerim Ismailaj ku konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile;
- Rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata e përbërë nën Betim të Chios, në vitin 2000, me tre vite burgim për veprën penale “Konflikt/Përleshje”, parashikuar nga neni 313 i Kodit Penal të Republikës së Greqisë, që i korrespondon veprës penale të “dëmtime të tjera me dashje” parashikuar nga neni 90/1 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, e cila si sanksion parashikon vetëm dënimin me gjobë;
- Ka qenë i dënuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr.11, datë 02.02.2023, për veprën penale “Falsifikimi i vulave dhe stampave”, ku është dënuar me katër muaj burgim të pezulluar ekzekutimin e tij dhe detyrimin për kryerjen e një pune me interes publik, pa shpërblim, për një kohë prej dyzet orësh;
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.10.2023*

- Rezultoni të ketë qenë në hetim për dy çështjet që raportova pak më parë
- Nuk rezultoni të ketë qenë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një veprë penale;
- Nuk rezultoni ti jetë caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale;
- Nuk rezultoni të jetë lëshuar ndonjëherë ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar;
- Nuk rezultoni të jetë jetë marrë për të masa e dëbimit nga një shtet i huaj;
- Nuk rezultoni të ketë të tjera indicie apo të dhëna e rrethana, fakte për veprimtari kriminale për qenjen e tij ose gjykim nga një autoritet i huaj, si dhe të ketë kërkim ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë veprë penale në ngarkim të tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit konstaton se: subjekti vetë deklarues, zoti Qerim Ismailaj, kryetar i Bashkisë Mallakastër, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet e ndalimit për kandidim, apo moszgjedhshmërisë.

Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin përkatës ku është dhe vendimi i Prokurorisë së Përgjithshme, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, bazuar në sa u raportua dhe në gjithë dokumentacionin që është administruar me këtë rast, konstatohet se:

- Zoti Qerim Ismailaj, kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit parashikuar nga ligji.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.10.2023*

- Mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tre ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

**Vendimi nr. 787**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.10.2023*

4.10.2023  
Ora 12:38

**RENDI I DITËS**

“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues zotin Fredi Pandi Kokoneshi, ish kryetar i Bashkisë Divjakë, Qarku Fier”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj.

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës!

**Z. Y. Merkaj:** Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019, zoti Fredi Pandi Kokoneshi, kandidat për kryetar të Bashkisë Divjakë, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 2660. Në bazë të kompetencave të veta, KQZ bëri verifikimin paraprak të formularit të vetëdeklarimit, ku konstatohet se nuk ka qenë në kushtet e ndalimit. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të zotit Fredi Kokoneshi, rezulton se pyetjes “A keni jetuar jashtë shtetit për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

- Në vitin 1992 ka qëndruar për një periudhë dy mujore në Greqi;

- Në vitin 1993-1996 ka qëndruar në Itali, për arsye emigrimi.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.10.2023*

Në përfundim të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve sipas të cilit zoti Fredi Kokoneshi, u shpall fitues në funksionin e kryetarit të Bashkisë Divjakë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas ushtrimit të nismës nga 1/10 e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ka kërkuar verifikim të thelluar për disa të dhëna të deklaruara nga zoti Fredi Kokoneshi, në zbatim të ligjit 138/2015. Drejtorja e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin për kryerjen e të gjitha verifikimeve përkatëse. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, ka kërkuar përsëri verifikimin e të dhënave, ku Prokuroria e Përgjithshme në datën 19.07.2023, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin zotin Fredi Kokoneshi, ku konstatohet konstatohet:

- Nuk rezulton të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile;
  - Nuk rezulton të jetë dënuar, për kryerjen e një vepre penale me vendim të formës së prerë;
  - Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor për një çështje penale të pazgjidhur;
  - Nuk rezulton të ketë qenë person në hetim në ndonjë procedim penal;
  - Nuk rezulton të ketë qenë i ndaluar apo arrestuar në flagrance;
  - Nuk rezulton të jetë caktuar ndonjëherë ndaj tij masë shtrënguese e sigurisë personale;
  - Nuk rezulton të jetë lëshuar ndonjëherë ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar;
  - Nuk rezulton të jetë marrë ndonjëherë për të masa e dëbimit nga një shtet i huaj;
- Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, konstatohet se:

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.10.2023*

Zoti Fredi Pandi Kokoneshi, ish kryetar i Bashkisë Divjakë, si rezultat i zgjedhjeve të zhvilluara për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, nuk e ushtron këtë detyrë dhe nuk është subjekt i këtij ligji. Komisioneri nuk mund të shprehet me vendimmarrje për çështjen objekt shqyrtimi, për sa kohë ky subjekt nuk gëzon statusin e kryetarit të bashkisë dhe për asnjë rrethanë dhe asnjë arsye, nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar dhe procedura administrative e verifikimit të thelluar. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të neneve 10 dhe 11 të ligjit 138/2015, si dhe neneve 90 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative e cila ka filluar përpara ditës së zgjedhjeve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, me pak fjalë, meqenëse ky subjekt nuk ka marrë mandat dhe nuk ka asnjë mundësi ligjore për të marrë mandat, do të përfundojmë procedurën administrative të shqyrtimit të kësaj çështje pa vendim përfundimtar.

**Vendimi nr. 788**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.10.2023*

4.10.2023  
Ora 12:42

**RENDI I DITËS**

*“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues zotin Pashk Gjergj Gjetaj, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Pukë, i propozuar nga subjekti Lëvizja e Legalitetit”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj.**

**Parti Politike: S’ka prezent!**

**Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës!

**Z. Y. Merkaj:** Zoti Pashk Gjergj Gjetaj, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Pukë, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 13440. KQZ bëri verifikimin paraprak të formularit të vetëdeklarimit, ku konstatohet se nuk ka deklaruar të dhëna që kanë të bëjnë me parashikime për ndalime në ligjin nr.138/2015. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit konstatohet se:

- Në rubrikën “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, i është përgjigjur “PO”, pyetjes “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj”? duke deklaruar se:

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.10.2023*

- është marrë masa e dëbimit nga shteti grek për shkelje të paligjshme të kufirit në vitin 1994, 1995, 1996.

Gjithashtu, pyetjes “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “po”, duke deklaruar se ka qëndruar për arsye ekonomike në Selanik, nga viti 1992-1995. Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme. Në datën 12.9.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin zotin Pashk Gjetaj”, ku konstatohet se nuk është në kushtet e ndalimit. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, konstatohet se:

Zoti Pashk Gjergj Gjetaj, kandidat i listës shumemërore të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja e Legalitetit për Këshillin e Bashkisë Pukë, Qarku Shkodër, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, nuk ka marrë asnjë mandat në këshillin bashkiak. Subjekti zgjedhor Partia Lëvizja e Legalitetit, referuar nenit 163 të Kodit Zgjedhor nuk ka fituar asnjë mandat në Bashkinë Pukë. Në kushtet kur subjekti vetëdeklarues, kandidat i listës shumemërore të Partisë Lëvizja e Legalitetit, nuk do të mund të përfitojë mandat në Këshillin e Bashkisë Pukë, duke ju referuar dhe nenit 11 të ligjit 138/2015, si dhe neneve 90 dhe 95 të ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative e cila ka filluar përpara ditës së zgjedhjeve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.10.2023*

**Z. I. Celibashi:** Edhe për këtë subjekt deklarojmë procedurën administrative të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar, për arsyet të cilat u relatuan nga ana juaj.

**Vendimi nr. 789**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.10.2023*

4.10.2023  
Ora 12:45

**RENDI I DITËS**

*“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues zotin Ronald Thoma Zhezha, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Fier, i propozuar nga subjekti Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj.**

**Parti Politike: S’ka prezent!**

**Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

**Z. Y. Merkaj:** Zoti Ronald Thoma Zhezha, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Fier, në datë 31.3.2023, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 6964. Nga verifikimi paraprak konstatohet se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit. Nga konstatimi i formularit të vetëdeklarimit konstatohet se subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, ka ndryshuar rubrikën e emrit nga “Roland” në “Ronald” dhe se ndaj tij është marrë masa e dëbimit nga një shtet i huaj në vitin 2000, për arsye emigrimi. Gjithashtu ka jetuar më shumë se dy muaj në shtetin Grek dhe në Itali për arsye emigrimi. Nga konstatimet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur t’ia kalojë rastin për verifikim të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.10.2023*

thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ka depozituar në KQZ datë 12.9.2023, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin zotin Ronald Zhezha, ku rezulton që nuk është në kushtet e ndalimit. Për sa më sipër subjekti vetëdeklarues, zoti Ronald Thoma Zhezha, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Fier, i propozuar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit, apo moszgjedhshmërisë. Koalicioni “Bashkë Fitojmë” në Këshillin e Bashkisë Fier, ka fituar pesëmbëdhjetë mandate dhe zoti Ronald Thoma Zhezha, kandidat i listës shumëmemërore të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” nuk ka marrë mandatin e anëtarit të Këshillit të Bashkisë Fier, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë,

- Për kandidatin për anëtar të Këshillit të Bashkisë Fier, të propozuar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, zotin Roland Zhezha, konstatojmë se nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të anëtarit të këshillit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tre ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

**Vendimi nr. 790**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



4.10.2023  
Ora 12:47

**RENDI I DITËS**

*“Për plotësimin e vakancave: në Këshillin e Bashkisë Pukë, me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zonjën Shpresa Musa Pemaj dhe Këshillin e Bashkisë Mirditë, me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zonjën Marina Frederik Vorfi”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj.**


**Parti Politike: S’ka prezent!**

**Të tjerë: KRIIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me plotësimin e vakancave!

**Z. Y. Merkaj:** Këshilli i Bashkisë Pukë dhe Mirditë kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave, për shkak të dorëheqjes së dy këshilltarëve. Kandidatët vijues nga listat shumemërore të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, në të dy këshillat bashkiakë kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit konstatohet se nuk rezulton të kenë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalim të ligjit nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore për të dy këta kandidatë, ku konstatohet se kandidatët nuk kanë ndryshime

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.10.2023*

në përbërës të gjendjes civile dhe nuk janë të dënuar me vendim penal të formës së prerë. Mbështetur në pikën 2, Kreu V, të vendimit 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatëve për anëtarë të këshillave Pukë dhe Mirditë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tyre në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimet për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Atëherë, bëjmë plotësimin e vakancave sipas drafteve të propozuara. Kemi çështje të tjera?!

**Z. Y. Merkaj:** Jo nuk kemi!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Seanca mbyllet!

**Vendimi nr. 791, 792**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

